



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:258314  
Datë: 19.09.2024  
Numri i dokumentit: 06181677

**Në çështjen juridike të :** **AC-I-23-0476-A0001**

*Paditëse/Ankuese*

**K G**, Prishtinë

**Kundër:**

*E paditura*

**SH.P.K. “NewCo Grand Hotel”** (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1477, të datës 28 korrik 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

1. Ankesa e paditëses është e bazuar.
2. Anulohet Aktvendimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1477, i datës 28 korrik 2023.
3. Lënda kthehet në rigjykim në shkallë të parë tek gjyqtari/ja përkatës.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 5 gusht 2015, paditësja kishte parashtruar një ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN173-0266 të datës 25 qershor 2015, me të cilin vendim kërkesa e paditëses për kompensim për 8 paga të papaguara në shumën prej 1,680.80 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa ishte parashkruar dhe nuk ka asnjë provë që parashtruesja e kishte dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent më parë.

Në ankesë paditësja kishte theksuar se N.SH në fjalë i ka mbetur borxh të njëjtës 8 paga të papaguara dhe atë për muajin dhjetor 2011, janar 2012-korrik 2012 dhe 6 ditë për muajin gusht 2012. AKP-ja me shkresën e datës 6 gusht 2012 me nr. 241 i ka njoftuar të gjithë punëtorët e ndërmarrjes se lidhur me kërkesat tona për paga të papaguara do të shqyrtohen në mënyrë meritore me rastin e fillimit të procedurës së likuidimit ku edhe të njëjtit vepruan në atë mënyrë. Andaj, e njëjta bazuar në faktet dhe provat e dorëzuara kërkon nga gjykata që t'i kompensohen 8 pagat e mbetura borxh për periudhën dhjetor 2011 deri me 6 gusht 2012 në shumën prej 1,680.80 euro me interes ligjor. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN173-0266 të datës 25 qershor 2015, një njoftim për paditësen nga AKP i datës 2 shkurt 2015 me nr. prot.847/15-out, kopjen e librezës së punës së paditëses, kopjen e letërnjoftimit, një kërkesë e punëtorëve të N.SH-së për kompensimin e kontributeve të trustit pensionale të mbetura nga New Co Grand Hotel sh.p.k, e datës 20 shkurt 2012, njoftim të datës 26 mars 2012 nga Shoqata Sindikale e Grand Hotel për AKP-në, Vendimet e Shoqatës Sindikale të Grand Hotel të datës 2 prill 2012 dhe 27 korrik 2012, Përgjigje në shkresë e AKP-së e datës 7 gusht 2012, një Aktvendim i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të datës 16 mars 2012, listën me pagat e papaguara për muajt 12/2011 deri me 8/2012 e nënshkruar dhe vulosur nga N.SH "Grand Hotel Prishtina", përkatësisht drejtori financiar i N.SH-së, kontratën e punës të datës 1 prill 2014 ndërmjet paditëses dhe të paditurës, aneks kontratën e punës nr. 96 të datës 1 prill 2014, kontratën e punës ndërmjet paditëses dhe të paditurës të datës 1 janar 2015, një kontratë pune ndërmjet paditëses dhe të paditurës të datës 3 prill 2007, një kontratë pune ndërmjet paditëses dhe të paditurës të datës 3 janar 2007.

Me datë 9 qershor 2023, gjykata kishte lëshuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për paditësen në shumë prej 20.00 euro. Tentimi i dorëzimit të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore kishte dështuar, prandaj me datë 4 korrik 2023, është bërë publikimi i saj në Tabelën e Shpalljeve dhe atë nga data 23 qershor 2023 deri me 4 korrik 2023.

Me datë 28 korrik 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-15-1477 kishte konsideruar si të tërhequr padinë e paditëses. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi ishte theksuar se detyrimi për pagesën e taksës gjyqësore është detyrim themelor i palës për të ushtruar të drejtën e ndjekjes së një procesi gjyqësor pranë DHPGJS-së i cili detyrim duhet të përmbushet bashkë me hapjen e rastit në gjykatë, përkatësisht bashkë me dorëzimin e padisë. Pala paditëse në rastin konkret nuk e ka paguar shumën e caktuar në emër të taksës gjyqësore dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të pagesës së saj edhe pse janë ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale të lartpërmendura. Andaj, duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura gjykata kishte vendosur si më lartë.

Me datë 16 gusht 2023, paditësja (ankuesja) kishte paraqitur ankesë kundër Aktvendimit C-IV-15-1477 të datës 28 korrik 2023, në të cilën kishte theksuar se parashtruesja e ankesës në rastin konkret nuk ka pranuar asnjë fletëthirrje për të paguar taksën e poashtu ka jetuar në adresën .. Prishtinë, por që në atë kohë është quajtur rruga..., e që emrat kanë ndryshuar nga ajo kohë dhe një kopje është dashur ti dërgohet në vendin e punës Grand Hotel sh.p.k që palës mos ti humbet e drejta në këtë kompensim. Andaj, ankuesja kërkon nga Kolegji i Apelit që të rishqyrtoj këtë ankesë dhe të pranoj si të bazuar duke marrë parasysh pretendimet ankimore dhe të vendoset në pajtim me dispozitat ligjore sepse e njëjta nuk dëshiron që lënda e saj të zvarritet apo të konsiderohet e tërhequr për një taksë gjyqësore.

Me datë 7 mars 2024, e paditura kishte paraqitur përgjigje në ankesë duke i propozuar Kolegjit të Apelit që e njëjta të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHPGJSK), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda i kthehet të njëjtit gjyqtar/e në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-15-1477 të datës 28 korrik 2023 kishte konsideruar si të tërhequr ankesën e ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore e cila i është dërguar 2 herë dhe më pas është publikuar në Tabelën e Shpalljeve pas dështimit të dorëzimit-pranimit të dokumentit.

Ankuesja kishte paraqitur ankesë në shkallë të dytë ndaj Aktvendimit të lartcekur, në të cilën ankesë kishte theksuar se në rastin konkret nuk ka pranuar asnjë fletëthirrje për të paguar taksën e poashtu ka jetuar në adresën rr., Prishtinë, por që në atë kohë është quajtur rruga...

Kolegji i Apelit duke i analizuar shkresat e lëndës erdhi në përfundim se Aktvendimi i ankimuar është i drejtë, mirëpo i njëjti duhet të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjyqtarit përkatës në rishqyrtim për arsyet si në vijim.

Kolegji i Apelit gjeti se Zyrtari për Financa e DHPGJS-së me datë 9 qershor 2023 kishte lëshuar një vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore për paditësen e cila brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kësaj vërejtje kishte kohë të paguante taksën gjyqësore.

Duke u bazuar në shkresa të lëndës shihet që dy (2) herë është bërë tentim dorëzimi i vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore mirëpo kishte rezultuar me dështim. Pas kësaj ishte bërë shënim zyrtar dhe ishte bërë publikimi i urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore në Tabelën e Shpalljeve nga data 23 qershor 2023 deri me 4 korrik 2023.

Në ankesën e paditëses të ushtruar ndaj Aktvendimit të lartcekur theksohet se e njëjta jeton në po të njëjtën adresë dhe nuk është shpërngulur, pasi që po të ishte shpërngulur nuk do kishte qenë e mundur ta pranonte Aktvendimin të cilin e ka ankimuar, në po të njëjtën adresë.

Kolegji i Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe ankesës së paditëses ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk kemi dërgim ligjor të parashtrës nga Dhoma e Posaçme. Andaj pala në këtë rast nuk duhet të pësoj për shkak të neglizhencës/ apo pa përgjegjësisë së zyrtarit të postës gjatë dërgimit të parashtrës, përkatësisht verifikimit të rregullsisë së adresës dhe personit të cilit i dërgohet parashtrës.

Prandaj, Kolegji i Apelit kishte vlerësuar se në rastin konkret pala ankuese nuk duhet të pësoj për shkak të gabimit të zyrtarit të postës për arsye se ndryshimi i emrit të rrugës në të cilën kishte banuar dhe ende banon ankuesja duhej të ishte fakt i njohur për zyrtarin e postës.

Për këtë arsye, Aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe të kthehet në rigjykim në shkallë të parë tek gjyqtari përkatës.

Andaj, duke pasur parasysh të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 19 shtator 2024.

Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_